



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-32442/22 datë: 17.11.2022



Npi – 01/382, datë: 28.11.2022

Në mbështetje të nenit 12.2. pika (c), nenin 40.2 pika (g), dhe nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008); Nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë, Npi – 01/205 datë: 14.07.2017; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna; Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Rregulloren e (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores të (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunës. Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 28.11.2022 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR KOMUNIKIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN PËR PERIUdhËN 2023-2025

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -XI- (njëmbëdhjetë) të rregullt për vitin 2022, të mbajtur më: 28.11.2022, unanimisht miratoi Strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun në Komunën e Shtimes për periudhën 2023-2025.

II

Vendimi është aprovuar pas diskutimit publik me qytetarë, si dhe duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Kryesuesit të Komisionit, Drejtorive, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi